VENDIM
Nr.130, datë 22.10.2010

PËR HEQJEN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV KUÇOVA"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	Kryetare
Alban Karapici	Zëvendëskryetar
Suela Musta	Anëtare
Sami Neza	Anëtar
Gent Ibrahimi	Anëtar
Zylyftar Bregu	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Heqje e licencës së subjektit televiziv privat vendor "Tv Kuçova".

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 3, neni 34 pika 5 dhe neni 137/3, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimet nr.891, datë 6.11.2009, dhe nr.52 datë 28.7.2010 të KKRT-së,

VËREN SE:

Me vendimin nr. 52, datë 28.7.2010, KKRT-ja ka vendosur paraprakisht heqjen e licencës së subjektit televiziv privat vendor "Tv Kuçova". Sipas pikës dy të vendimit të sipërcituar, subjekti "Tv Kuçova" kishte të drejtë që brenda një muaji të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim. Edhe pse ky afat ka kaluar, rezulton se ky subjekt nuk ka paraqitur asnjë pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin nr.52, datë 28.7.2010 të KKRT-së.

Nga inspektimet e kryera në qytetin e Kuçovës dhe të Beratit, nga specialistët e drejtorisë teknike në KKRT, ka rezultuar se ky operator televiziv, për periudhën 7 mujore janar 2010 - korrik 2010, ka ndërprerë transmetimin për të mbuluar me sinjal zonën e tij të licencimit.

Bazuar në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, neni 34 pika 5 "Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:

... 5. pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës ..."

Nga verifikimet e kryera në qytetin e Beratit konstatohet se subjekti e ka mbyllur studion e tij të transmetimit.

Gjithashtu, rezulton se ky subjekt nuk ka qenë i rregullt në kryerjen e pagesave vjetore për licencë dhe taksë për shërbime radiotelevizive, sipas faturave të dërguara nga Drejtoria Ekonomike për vitet 2008-2009.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bazë të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 3, nenit 34 pika 5 dhe nenit 137/3, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. T'i heqë licencën subjektit televiziv privat vendor "Tv Kuçova".

2. Licenca me nr. 013/TVL, bëhet e pavlefshme.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, Kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati